



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.129 dt.30.10.2001

**PER  
MIRATIMIN E PROJEKTIT "REHABILITIMI, VENDOSJA E PUSHTAVE TE  
RRJETIT INXHINIERIK NE DISA RRUGE TE QYTETIT TE TIRANES**

Në mbështetje të nenit 32, gërma dh të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor", Ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 "Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.22 dt.13.02.2001 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2001 për Bashkinë Tiranë", në bazë të projekteve dhe relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratojë projektin "Përmirësimi, vendosja e pushtave të rrjetit inxhinjerik" në shumën prej 4.900.000 lekësh sipas preventivit bashkëngjitur
2. Fondi prej 4.900.000 lekësh të përballohet nga zëri "Projektme (përfshirë dhe materialet nga Instituti i Gjeologjisë)"
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**









